



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 48, QARKU ELBASAN,
PËR ZGJEDHJET ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30.06.2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 14.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 48, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, e ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2560 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Elbasan, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Elbasan që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për dhjetë (10) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 1560/1 prot., datë 07.05.2019, i ka paraqitur KQZ-së listën e objekteve të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për KZAZ-të e Qarkut Elbasan.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr. 48, Qarku Elbasan, është:



Nr. 318 i Vendimit Data 14.05.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.48, Qarku Elbasan,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

1. Palestra e Shkollës së Mesme "Dhaskal Todri", me sipërfaqe 250 m², Bashkia Elbasan;

Ambienti i propozuar ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet e mëparshme, ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 48, në Palestrën e Shkollës së Mesme "Dhaskal Todri", me sipërfaqe 250 m², Bashkia Elbasan.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 318 i Vendimit Data 14.05.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.48, Qarku Elbasan,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.